



## PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

I DETYRUAR

### SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI **A**

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Gjimnazi: Drejtimi natyror

*Udhëzime të përgjithshme:*

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

**PJESA I****Ernest Koliqi****Kërcimtarja e Dukagjinit (fragment)**

Pyetja 1	A	1 pikë
Pyetja 2	D	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	C	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë
Pyetja 6	C	1 pikë

**Pyetja 7 2 pikë****Model përgjigjeje**

- a) Ngjarja që pritet të ndodhë është *dhënia e çmimit* për kërcimtarin.
- b) Detaji që pengon zhvillimin e mëtejshëm të ngjarjes është *hyrja e kërcimtarit, Lules*.

<b>2 pikë</b>	Nëse nxënësi tregon se cila është ngjarja.
<b>DHE</b>	Nëse nxënësi gjen detajin.
<b>1 pikë</b>	Nëse nxënësi tregon vetëm ngjarjen ose vetëm detajin.
<b>0 pikë</b>	Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

**Shënim:**

*Ngjarja dhe detaji* mund të jepen edhe me ilustrim nga fillimi i fragmentit.

**Pyetja 8 4 pikë****Model përgjigjeje**

- a) Lulja shfaqet para të pranishmëve me *bukurinë fizike* dhe me *kërcimin fantastik* (talentin e saj).  
*Ajo është e bukur dhe e talentuar.*  
*Ajo prezanton bukuri dhe mrekulli.*

**Ose**

*Tiparet e Lules mund të jepen me ilustrime dhe perifrastime nga fragmenti.*

- b) **Similituda:** *si një amë lulesh mali / si një gurgullim krojesh të ngrita / si lule qi sa po ka çelë*
- c) gjith shpirtnat- përcakton gjithpërfshirjen dhe ngazëllimin shpirtëror të të gjithëve.

<b>4 pikë</b>	Nëse nxënësi zbulon dy tiparet e Lules. Nëse nxënësi gjen njërin nga similitudat. Nëse nxënësi shpjegon përcaktorin.
<b>3 pikë</b>	Nëse nxënësi zbulon vetëm njërin tipar të Lules, gjen similitudën dhe jep rolin e përcaktorit.
<b>3 pikë</b>	Nëse nxënësi zbulon vetëm dy tiparet dhe gjen similitudën.
<b>3 pikë</b>	Nëse nxënësi zbulon vetëm dy tiparet dhe shpjegon përcaktorin.
<b>2 pikë</b>	Nëse nxënësi zbulon vetëm dy tiparet e Lules.
<b>2 pikë</b>	Nëse nxënësi zbulon vetëm similitudën dhe shpjegon përcaktorin.
<b>2 pikë</b>	Nëse nxënësi zbulon njërin tipar të lules dhe gjen similitudën.
<b>2 pikë</b>	Nëse nxënësi zbulon njërin tipar dhe shpjegon përcaktorin.

- 1 pikë** Nëse nxënësi gjen vetëm similitudën.  
**1 pikë** Nëse nxënësi zbulon vetëm njërin tipar të Lules.  
**1 pikë** Nëse nxënësi shpjegon vetëm përcaktorin.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Shënim:**

*Nxënësi do të marrë pikë të plota ose të pjesshme në çdo rast kur përgjigja e tij i afrohet logjikës së pyetjes dhe modelit të përgjigjes së dhënë në skemë, pavarësisht formulimit individual të përgjigjes.*

**Pyetja 9 2 pikë****Model përgjigjeje**

- a) Rrëfimi është në *vetën e tretë*.  
 b) Rrëfimi në këtë vetë e vendos lexuesin në *syrin e vetë autorit*. Lulja kërcen dhe të tjerët shijojnë kërcimin e saj. Lexuesi është si *spektator rreth skenës së kërcimit*. Ndërkohë ai *sodit* dhe *detajizon* çdo element të këtij kërcimi etj.  
**2 pikë** Nëse nxënësi tregon vetën dhe shpjegon efektin e saj te lexuesi.  
**1 pikë** Nëse nxënësi tregon vetën e rrëfimit.  
**1 pikë** Nëse nxënësi shpjegon rolin e përdorimit të vetës së tretë.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Shënim: për pikën b)**

*Nxënësi do të marrë pikë te kërkesa b), në çdo rast kur përgjigja e tij i afrohet logjikës së pyetjes dhe modelit të përgjigjes së dhënë në skemë, pavarësisht formulimit individual të përgjigjes.*

**Pyetja 10 3 pikë****Model përgjigjeje**

- a) **mbiemrat:** *madhshore, të denduna, të panjehuna, e lehta, të lëshuem, të bardhë, hyjnuer.*  
 b) Koliqi njihet për përdorimin e mbiemrit, i cili i jep *cilësi artistike përshkrimit, e poetizon atë*. Mbiemri luan rol *karakterizues e përshkrues*. Ai e bën përshkrimin plot *gjallëri e lëvizje, gjithëpërfshirës, ngazëllyes, dallues*, etj.  
**3 pikë** Nëse nxënësi gjen dy mbiemra.  
 Nëse nxënësi shpjegon rolin e mbiemrave.  
**2 pikë** Nëse nxënësi gjen vetëm dy mbiemrat ose vetëm njërin mbiemër dhe shpjegon rolin e tyre.  
**1 pikë** Nëse nxënësi gjen vetëm njërin nga mbiemrat ose shpjegon vetëm rolin e mbiemrave.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Shënim: për pikën b)** *do të pranohen variante përgjigjesh të ndryshme nga skema, mjafton që ato të afrojnë me logjikën e pyetjes dhe të jenë të formuluar qartë.*

**Pyetja 11**            **3 pikë****Model përgjigjeje**

a) Personazhet në fund të fragmentit reagojnë *me brohori, mahnitje*. Ata shprehin *kënaqësi*, dhe reagojnë *të gjithë* pa përjashtim.

Është e qartë që ata janë *të impresionuar* nga gjithë ajo sa panë. Reagojnë *menjëherë* pas kërcimit dhe i thurin vajzës *lavde* në shkallën sipërore, etj.

Reagimi është: *impresionues, gjithpërfshirës, i menjëhershëm, plot lavde*, etj.

b) Për të treguar gjithpërfshirjen përdoret figura e sintaksës poetike: *enumeracioni*.

c) Nëna habitet njësoj si të tjerët sepse: Lulja *kurrë më parë* nuk kishte shfaqur cilësi të kësaj natyre, Lulja në shtëpi njihej si një vajzë me fytyrë të bukur, por *pa asnjë lloj dhuntie* tjetër. Nëna çuditet njësoj si të tjerët nga *mrekullia e kërcimit, etj.*

**3 pikë**            Nëse nxënësi jep një karakteristikë, gjen enumeracionin dhe shpjegon arsyen e habitës së nënës.

**2 pikë**            Nëse nxënësi jep vetëm dy nga tri përgjigjet e kërkuara më lart.

**1 pikë**            Nëse nxënësi jep vetëm një të një nga përgjigjet e kërkuara më lart.

**0 pikë**            Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Shënim:**

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë për pikën a) dhe c) jep formulime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që afrojnë me këtë model dhe me logjikën e pyetjes.*

**Pyetja 12**            **2 pikë****Model përgjigjeje**

Një nga veçoritë e stilit të Koliqit është edhe fakti se ai i sheh *personazhet e tij nga një këndvështrim i veçantë*. Bota e tyre shpjegohet me ndryshimet që ndodhin duke lidhur *veprimet me gjendjet*, duke i parë ata të funksionojnë në bazë të *lidhjeve shkak-pasojë* ose nga *brenda – jashtë*, etj.

Në rastin tonë Lulja, që *kërcen (veprimi)* dhe shija e magjia e tij kalon si *përjetim dhe mrekulli të të pranishmët (përjetimi)*.

Pasi të përshkruhet kërcimi, jepet edhe përjetimi i personazheve të tjerë për të, etj.

**2 pikë**            Nëse nxënësi shpjegon dy konceptet *veprim dhe përjetim*.

**1 pikë**            Nëse nxënësi shpjegon vetëm njërin koncept.

**0 pikë**            Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Shënim:**

*Nxënësi do të marrë pikë për çdo formulim përgjigjeje pavarësisht formës individuale të saj, kur ajo përputhet me logjikën e pyetjes dhe me logjikën e orientimit në skemën e vlerësimit*

**PJESA II****ESKILI****Koeforët (fragment)**

Pyetja 13	C	1 pikë
Pyetja 14	A	1 pikë
Pyetja 15	D	1 pikë
Pyetja 16	A	1 pikë
Pyetja 17	D	1 pikë
Pyetja 18	C	1 pikë
Pyetja 19	B	1 pikë

**Pyetja 20**      **3 pikë****Model përgjigjeje****a) Detajet:**

- pik' së pari duhet të marr vesh,
- apo s' është tjetër veç thashetheme,
- diçka të sigurt ti a mund të thuash?,
- do ta shoh vetë shtegtarin,
- e pa me syt' e tij tek hiqte shpirt,
- Apo mos flet me ç'ka dëgjuar turbull?  
Unë kam nuhatje, nuk gabohem lehtë.
- etj.

**b) Mosbesimi i Egstitit buron nga *frika e tij për hakmarrjen e mundshme të Orestit.***

<b>3 pikë</b>	Nëse nxënësi gjen dy nga detajet dhe jep shpjegimin.
<b>2 pikë</b>	Nëse nxënësi gjen vetëm dy detajet ose njërin nga detajet së bashku me shpjegimin..
<b>1 pikë</b>	Nëse nxënësi gjen vetëm njërin detaj ose jep vetëm shpjegimin.
<b>0 pikë</b>	Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Shënim:**

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që afron me logjikën e pyetjes dhe që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 21**      **3 pikë****Model përgjigjeje****a) fjalët antonimike: *shuhet - ndez***

**b) Vargjet nga janë shkëputur këto fjalë japin idenë që *hakmarrja* do të ndodhë *në emër të së drejtës*. Oresti ka të drejtë të marrë hakun e të atit, *me të drejtën legjitime të trashëgimit të fronit*. Por ndërkohë Eskili na mëson *se e drejta është e dyanshme*. Ajo është edhe në krahun tjetër, në momentin që Oresti rreket të kryejë krimin, etj.**

Në fragment është momenti kur *kjo e drejtë ose shuhet ose ndizet*.

c) nënteksti i shprehjes *zjarri në vatër* është i lidhur me *figurën atërore*, mbajtjen gjallë të *vazhdimësisë së jetës, trashëgiminë e fronit* ose të *Kryetarit* legjitim të fisit, familjes, atij që qëndron *në krye të vatrës*, atij që ndez zjarrin, etj.

- 3 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet për pikën a) b) c).  
**2 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet vetëm për dy nga pikat më lart.  
**1 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet vetëm për një nga pikat më lart.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Shënim:** për pikën b) dhe c).

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por është në logjikën e pyetjes dhe që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

## Pyetja 22 3 pikë

### Model përgjigjeje

a) *Agamemnoni, Ifigjenia*. (pranohen edhe përgjigje si: ati i Orestit, mbreti, e bija e Agamemnonit, motra e Orestit etj).

b) Gjendja psikologjike e Egistit është e lidhur me ndjenjën *e ankthit dhe të frikës*, që ai ndjen nga hakmarrja e Orestit. Ai e di mirë që *po vrave do të të vrasin*. Ndërkohë ai njuh *mekanizmin e të drejtës* që ka Oresti për të qenë *trashëgimtar i ligjshëm i fronit*, etj.

Gjendja e tij është e mbushur me *frikë, ankth, pasiguri* dhe është *tejet e rënduar* nga çasti që po afron.

- 3 pikë** Nëse nxënësi gjen dy vrasjet dhe shpjegon gjendjen e Egistit..  
**2 pikë** Nëse nxënësi shpjegon gjendjen e Egistit dhe jep vetëm njëren nga vrasjet, ose jep vetëm dy vrasjet.  
**1 pikë** Nëse nxënësi jep vetëm shpjegimin ose vetëm njëren nga vrasjet.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Shënim:**

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një përshkrim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që ka lidhje me logjikën e pyetjes dhe që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

## Pyetja 23 2 pikë

### Model përgjigjeje

a) *Pasthirrma*: Bobo, bobo! ...

b) *Përsëritja e saj rrit tensionin dramatik, i jep intensitet ndjenjës dhe përjetimit, krijon efekt skenik, etj*

- 2 pikë** Nëse nxënësi gjen pasthirmën dhe shpjegon rolin e pasthirmës.  
**1 pikë** Nëse nxënësi jep vetëm njëren nga përgjigjet..  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Shënim:** *Shpjegimi i nxënësit për përsëritjen do të vlerësohet pozitivisht edhe kur formulimi i tij nuk është si në pikën b), por përgjigja e tij ndjek logjikën e pyetjes dhe afron me përgjigjen e skemës.*

**Pyetja 24**                      **2 pikë****Model përgjigjeje**

- a) Roli i korit në të gjithë veprat dramatike është *mbështetës, paralajmërues, shtytës i veprimit, tregues i emocionalitetit skenik*, etj. Në këtë fragment kori, *paralajmëron* se çfarë do të ndodhë dhe ndërkohë *mbështet* Orestin nisur nga e drejta që e shoqëron veprimin e tij.
- b) Kori i drejtohet Zeusit, sepse *personazhet* e veprave të antikitetit në veprimet e tyre *udhëhiqeshin nga perënditë*. Ky ishte edhe botëkuptimi i kohës.

**2 pikë**                      Nëse nxënësi shpjegon rolin e korit dhe pikën b).

**1 pikë**                      Nëse nxënësi shpjegon vetëm njërin prej tyre.

**0 pikë**                      Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Shënim:**

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një analizë që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që ka lidhje me logjikën e pyetjes dhe që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

---

**Pyetja 25**                      **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

**KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË**                      **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese;
  - ku argumenton pse fati njerëzor është i paracaktuar,
  - ku jep fakte mbi idenë që fati varet nga mekanizmi shkak – pasojë,
  - ku jep fakte që fati varet nga drejtimi që i jep vetë individi, duke treguar destinimin negativ, kur ai udhëhiqet nga pasione negative, sikundër është hakmarrja.
- shtjellon temën duke e lidhur me fatin e Orestit ose të tragjedisë në përgjithësi.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga jeta.
- përdor detaje mbështetëse.
- ka qartësi mendimi.

**KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË**                      **2 pikë****1 pikë**                      **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
  - hyrjen
  - zhvillimin
  - përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

**1 pikë**                      **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

**KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI**                      **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

**KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE**                      **2 pikë****(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.